

Plani Lokal Për Veprim në Mjedis për komunën e Mamushës



Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

2014 / 2019



Komuna : Mamushë

Projekti është financuar nga:



Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Zbatimi i projektit është mbështetur edhe nga:



MMPH dhe MAPL.

Ky projekt është zbatuar nga:



Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë

Përmbajtja

Ç'është REC ?

Fjala e Kryetarit të Komunës.....

Fjalorthi i shkurtesave....

Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së....

Pjesa e 1

I.Hyrje

Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së.....

Plani Lokal për Veprim në Mjedis ka për qëllkim.....

Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së.....

Dokumenti është hartuar mbi tri baza kryesore.....

Pjesa 2

II .Profili i komunës së Mamushës.....

2.1.Historiku I Mamushës.....

2.2.Karakteristikat hidrologjike dhe demografia.....

2.2.1.Kushtet klimatike.....

2.2.2.Ndryshimi Klimatik.....

2.2.3.Resurset natyrore.....

2.2.4.Vendbanimi.....

2.2.5. Popullsia e Mamushës.....

2.2.6.Dendësia e populates.....

2.3.Situata socio-ekonomike.....

2.3.1. Punësimi dhe papunësia.....

2.3.2. Barazia gjinore.....

2.3.3. Sherbimet publike.....

2.3.4.Organizimi i shoqërisë civile.....

2.3.5.Situata Sociale.....

2.3.6.Shkalla e varfërisë dhe asistencës sociale.....

2.3.7.Shëndetësia.....

2.3.8.Arsimi.....

2.4.Hapësirat publike.....

2.4.1.Parqet.....

2.4.2.Fushat sportive.....

2.5.Trashëgimia kulturore.....

2.5.1.Monumentet kulturore.....

- 2.5.2.Sahat Kulla – Kulla e Sahatit.....
- 2.5.3.Varrezat historike.....
- 2.5.4.Shtëpitë Historike.....
- 2.5.5.Festivalet.....
- 2.6.Infrastruktura publike.....
- 2.6.1.Llojet e rrugëve.....
- 2.6.2.Trotuaret.....
- 2.6.3.Vend parkingjet.....
- 2.6.4.Transporti publik.....
- 2.6.5.Rrjeti elektrik.....
- 2.6.6.Ndriqimi publik.....
- 2.6.7.Furnizimi me ujë të pijshëm.....
- 2.6.8.Rrjeti i kanalizimit.....
- 2.6.9.Mbeturinat
- 2.7.. Zhvillimi ekonomik.....
- 2.7.1. Situata ekonomike.....
- 2.7.2.Sektorët e punësimit.....
- 2.7.3.Tregtia.....
- 2.7.4.Bujqësija.....
- 2.7.5.Blegtoria.....
- 2.7.6.Turizmi.....
- 2.7.6.1.Turizmi kulturor.....
- 2.7.6.2.Shtegu i domates.....
- 2.7.6.3.Shtegu shpirtëror.....
- 2.7.7.Ekoturizmi.....
- 2.7.7.1.Korridoret e gjelbra.....
- 2.7.7.2.Shtegu i pyllit.....
- 2.7.7.3.Shtegu i lumit.....
- 2.7.7.4.Fontanat....

Pjesa 3

- III. Vleresimi i gjendjes mjedisore.....
- 3.1.Ndotja e mjedisit.....
- 3.1.1.Degradimi.....
- 3.2.Toka.....
- 3.2.1Përbërja e tokës.....
- 3.2.2.Toka bujqësore.....
- 3.2.3.Përdorimi i tokës.....

- 3.2.4.Ndotja e tokës.....
 - 3.2.5.Erozioni.....
 - 3.2.6.Zjarret.....
 - 3.2.7.Pyjet, Kullotat dhe Livadhet.....
 - 3.3.Uji.....
 - 3.3.1.Burimet e ujit.....
 - 3.3.2.Ndotja e ujërave.....
 - 3.3.3.Ujërat atmosferike.....
 - 3.3.4.Hudhja e mbeturinave ne lumej.....
 - 3.3.5.Ndotja e ujërave nëntoksore.....
 - 3.3.6.Vërshimet.....
 - 3.3.7.Përmbytja.....
 - 3.4.Ajri.....
 - 3.4.1.Ndotja e ajrit nga pluhuri.....
 - 3.4.2.Ndotja akustike-Zhurma.....
 - 3.5.Biodiversiteti.....
 - 3.5.1.Flora.....
 - 3.5.2.Fauna.....
 - 3.5.3.Problemet.....
 - 3.5.4.Rekomandimet.....
- Pjesa 4**
- IV. Planifikimi I veprimeve.....

Ç'është REC?

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) është organizatë ndërkombëtare neutrale, joavokuese dhe jofitimprurëse, e cila mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL). Kjo qendër e përmbush misionin duke promovuar bashkëpunim ndërmjet Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), qeverive, bizneseve si dhe personave tjerë kyç mjedisor si dhe duke përkrahur këmbimin e lirë të informatave dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen për mjedis. REC është themeluar në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria.

Aktualisht, REC bazohet ligjërisht në Kartën e vet, nënshkruar nga qeveritë e 29 vendeve dhe Komisioni Evropian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë e Hungarisë. Zyra qendrore e REC-ut është në Szentendre, Hungari si dhe zyrat fushore dhe zyrat e shteteve në 17 vendet përfituese.

Fjala e kryetarit

Fjalorthi i shkurtesave

AKMM – Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

APK – Agjencioni Pyjor i Kosovës

ASK – Agjencioni i Statistikave të Kosovës

BE – Bashkimi Evropian

IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës

MAPL – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MSHP – Ministria e Shërbimeve Publike

OBSH – Organizata Botërore e Shëndetësisë

OJQ – Organizata Joqeveritare

PKVM – Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVM – Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PNJK – Pilot Njësi Komunale
PZHK – Plani Zhvillimor Komunal
PZHU – Plani Zhvillimor Urban
QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
REC – Qendra Rajonale për Mjedis
SIDA – Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
VKE – Vlerat Kufitare të Emisioneve

Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së

Ky Projekt është implementuar nga:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC (Regional Environmental Center) - Zyra në Kosovë.

Koordinator i REC për PLVM:

Daut Blakaj

Komuna e Mamushës

Kordinator i komunës për PLVM:

Ylber Kastrati

Anëtarët e Grupit Punues:

1. Ylber Kastrati, Shef i Sektorit për Administratë, koordinator;
2. Yuksen Topoyani, Udhëheqës i sektorit për bujqesi,pylltari dhe hidroekonomi;
3. Erol Morina, shef i sektorit të arsimit;
4. Esra Osi, Shefe e Sektorit për zhvillim dhe planifikim;
5. Ibrahim Morina, Udhëheqës i zyrës për integritime evropiane dhe per të drejtat e njeriut;
6. Ajet Sadiku, Udhëheqës i sektorit për të drejtat dhe integritime të komuniteteve;
7. Nahit Butuc, nga OJQ "Asik Ferkil";
8. Samedin Taq,përfaqesues i bizneseve lokale;
9. Resat Mazrek, nga radhët e rinise "Mabed";

Anëtarët e trupit Kordinues:

1. Agim Morina, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime publike ,Mbrotje dhe Shpëtim, kryesues
2. Ganimete Sadiku- Nenkryetare për Komuntete, anëtare.
3. Seylan Mazrek, Kryesues i Kuvendit komunal, anëtar
4. Yahya Mazreku Drejtor i Drejtoratit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar
5. Cavit Mazrek, Drejtor i Drejtoratit për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
6. Ylber Kastrati, Përgjegjës për administratë, anëtar.

Pjesa 1

I . Hyrje

Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) janë dokumente të politikës mjedisore vendore, të cilat paraqesin prioritete mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtyre planeve zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin.

Gjithashtu, PLVM nxit bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së Përgatitja e PLVM-së është e detyrueshme për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që kanë filluar procesin e asocim-stabilizimit dhe që synojnë të integrohen në BE. Për vendin tonë, hartimi i këtyre planeve nga qeverisjet vendore është detyrë ligjore, e përcaktuar në Nenin 24 të Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-25

Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qëllim të:

- Zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Zhvillojnë shoqërinë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet, duke sjellë së bashku përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që përfaqësojnë interesa të ndryshme në këto komunitete, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJQ-ve, biznesin, shkencëtarë, duke shpjeguar teknikat specifike që organizatorët lokalë mund të përdorin për të përcaktuar aktorët kryesorë të procesit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në proces, për rekrutimin dhe punën me vullnetarët dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara dhe organizatave.
- Rrisin aftësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetit për paraqitjen e elementëve thelbësore të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, duke përfshirë publikun, përcaktimin e prioriteteve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një Plan Veprimi.

- Rrisin shkëmbimin e informacionit në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe modeleve nga plane të mëparshëm të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.
- Japin zgjidhje konkrete për problemet e komunitetit me anë të shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime që janë thelbësore për një veprim të komunitetit efektiv. Duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e mamushës u hartua përgjatë një periudhe njëvjeçare dhe në hartimin e tij, janë përfshirë akterë të pushtetit vendorë dhe komuniteti i gjerë. Për këtë u ngrit një grup pune me specialistë të fushave të ndryshme (ambientalizëm, arkitekturë, turizëm,shëndetësi, arsim, sport, trashëgimi kulturore, etj.), të cilët punuan në bashkëpunim me ekspertë tjerë vendor dhe ndërkombëtarë për hartimin e PLVM.

Së pari, është bërë trajnimi i grupit punues të cilët u ftuan në projekt në aspektet e hartimit të PLVM-së dhe gjetjes së mjeteve shtesë për realizimin e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë mjedisore.

Në kuadër të projekti për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), është bërë një anketim i qytetarëve të Komunës së Mamushës. Ka qenë një numër i konsiderueshëm i pyetësorëve,të cilët kanë ndihmuar dhe orientuar grupin punues në mënyrë më të drejtë në zgjedhjen e fushave prioritare. Një falënderim për këtë i takon qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit dhe shoqërisë civile, e cila në procesin e anketimit të respondentëve ka ndihmuar që procesi i anketimit të jetë i suksesshëm. Për të pasur një përfshirje sa më të gjerë dhe për të marrë mendimet e komunitetit dhe shoqërisë civile, janë organizuar edhe debate publike dhe debate në media.

Procesi themelor i hartimit të PLVM-së ndahet në faza, të cilat lidhen njëra pas tjetrës:

- a) Nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit në mes të REC – Komunë;
- b) Aktivitetet përgatitore;
- c) Formimi i trupit koordinues TK;
- d) Formimi i grupit punues GP;
- e) Trajnimi i anëtarëve të GP;
- f) Vizionimi i komunitetit;

- g) Vlerësimi i gjendjes së mjedisit;
- h) Anketimi i qytetarëve;
- i) Caktimi i prioriteteve;
- j) Hartimi i planit të veprimit për fushat prioritare dhe;
- k) Caktimi i prioriteteve në realizimin e planit të veprimit

Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:

1. Analiza e gjendjes mjedisore

Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë Komunën e Mamushës.

2. Lista e problemeve mjedisore

Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe prioriteti për secilin.

3. Plan i veprimeve për zgjidhje

Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara. Kjo matricë u shërben autoriteteve vendore për të hartuar projektet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.

Vizioni

MAMUSHA E MBËSHTETUR NË BUJQËSI, ZHVILLIM EKONOMIK TË QËENDRUESHËM, MJEDIS TË GJELBERT, RUAJTJE TË TRASHËGIMISË NATYRORE E KULTURORE, ME INFRASTRUKTURË DHE EKOTURIZEM TË AVANCUAR

Pjesa 2

II .Profili i komunës së Mamushës

2.1.Historiku I Mamushës

Mamusha ishte një fshat që i përkiste Komunës së Prizrenit deri në vitin 2005 kur ajo u krijua si një pilot komunë. Komuna e Mamushës është një komunë e vogël rurale në jug të Kosovës. Ajo kohët e fundit fitoi statusin si një qendër administrative dhe komunë, por ka funksionuar si një komunitet rural lokal që nga viti 1985.

Mamusha ka filluar të funksionojë si një pilot komunë në vitin 2005, pas nxjerrjes së një akti administrativ nga përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së. Pilot Komunës i ishte dhënë statusi i plotë në vitin 2008 pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe kufijtë administrative të Komunës. Administrimi aktual i komunës përbëhet nga zyra e kryetarit dhe gjashtë drejtorive komunale dhe sektorët e tyre të ndërlidhura.

Komuna e Mamushës shtrihet në rrafshin e Dukagjinit, pellgut të madh që mbulon pjesën jug-lindore të Kosovës. Ky rajon ka tokë të punueshme pjellore, e cila në kombinim me klimën e bën të përshtatshëm kultivimin bujqësor. Territori i komunës është i përbërë kryesisht prej terrenit të sheshtë në zonën qendrore, ndërsa në veriperëndim ka dy kodra Maçovina dhe Tiçanlik, ku janë të mbjella vreshta dhe një në Juglindje ku rriten shkurre / pyje. Komuna e Mamushës ka një lartësi prej 320-360 m mbi nivelin e detit me pikën më të lartë në kodrën Golubrade me 460 m. Dy lumenj rrjedhin përmes komunës, duke kaluar nëpër tokë të punueshme: më i madhi Toplluha e cila është degë e lumit Drini I Bardhë dhe një më i vogël me emrin Tërrnje.

Vendbanimi linear është i vendosur në një pjerrtësi në qendër të komunës, përgjatë një rrugë të ngushtë dhe gjarpëruese. Sipërfaqja e saj është 10.94 km² dhe është njëra nga njësitë komunale më të vogla në Kosovë. Koordinatat e komunës janë gjerësia 42° 20'40" dhe gjatësi 20° 43'47". Komuna në juglindje kufizohet me Komunën e Prizrenit, në verilindje me Komunën e Suharekës dhe në veriperëndim me Komunën e Rahovecit. Vendbanimi i vetëm në komunë është e komuna e Mamushës që gjendet në të dy anët e rrugës që lidh rrugën Piranë – Suharekë me rrugët regjionale Prizren-Prishtinë dhe Prizren – Shkup, ndërsa në jug lidh me Gjakovën dhe Pejë. Distanca nga qendrat e komunave fqinje është: nga Prizreni është 20 km, nga Suhareka është 10 km dhe nga Rahoveci 15 km.

2.2.Karakteristikat hidrologjike dhe demografia

2.2.1.Kushtet klimatike

Në komunën e Mamushës mbizotëron një klimë kontinentale, por ajo gjithashtu përjeton edhe një klimë mesdhetare për shkak të rrymës të ngrohtë të Adriatikut që vjen përmes kanjonit të lumit Drini i Bardhë. Kjo klimë është e përshtatshme për kultivimin e një sërë të prodhimeve bujqësore. Temperatura mesatare vjetore në komunë është 11.5 ° C. Temperatura më e lartë mesatare është 22,2 ° C në korrik-gusht, ndërsa më e ulët është 0 ° C në janar. Reshjet mesatare janë diku rreth 686 mm / vit.

2.2.2.Ndryshimi Klimatik

Ndryshimi klimatik e prek edhe Kosovën, në këtë rast edhe Mamushën, kjo mund të vërehet nga ngritjet e temperaturave, uljet e të rreshurave, vërshimeve dhe thatësirave. Ndryshimi klimatik drejtëpërdrejtë prek sektoret e zhvillimit dhe jetën e banorëve. Niveli i ulët i furnizimit me rrymë elektrike, ndërprerjet e shpeshta të rrymës elektrike, mungesa e ngrohjes qendrore dhe përdorimi i makinave dhe automjeteve për bujqësi janë disa nga çështjet që ndihmojnë ndryshimin klimatik, sepse banorët për të plotësuar nevojat e tyre ata prejné drunjët për ti përdorur për djegie dhe përdorin gjeneratorët diesel.

2.2.3.Resurset natyrore

Mamusha ka kryesisht terren të rrafshët, me tokë cilësore dhe klimë shumë të përshtatshme për bujqësi.Mamusha qendrore kryesisht është e mbuluar me fusha kurse në Veriperëndim janë dy kodra Maçovina dhe Tiçanlliku ku janë mbjellur vreshtat, dhe në juglindje është pylli (kaçuba). Pika më e lartë e komunës është Golubrada me 460m lartësi dhe pika më e ulët është në lartësinë 320 m që ndodhet në jug.Nëpër komunë rrjedhin dy lumenjë Toplluha që është lumi më i madhi dhe që derdhet në lumin Drini I Bardhë dhe lumi më i vogël Tërnya.

Një pjesë e madhe e tokës së Mamushës është e pasur me burime të ujërave nëntokësore që përdoren nga qytetarët për pije dhe për ujitjen e tokës bujqësore. Vendbanimi linear shtrihet mbi shpatije, në qendër të komunës, përgjatë rrugës së ngushtë dhe të gjarpërore.

Krahas fushave bujqësore, kodrave, lumenjve peizazhi i komunës është i pasur edhe me ndërtesa të ndryshme kulturore, hapësirat publike ku lidhja dhe kombinimi i këtyre elementeve natyrore dhe kulturore mund të kontribuojnë në

zhvillimin e karakterit të komunës përkatësisht vendbanimit. Pjesa më e madhe e tokës në Mamushë ka shumë burime ujore nëntokësore të pasura të cilat janë përdorur nga banorët për të pirë dhe për ujitjen e tokës së punueshme.

Pylli në pjesën lindore të komunës përbëhet nga Lisi (*Quercus sessiflora*), në formë kurore nga Dëllinja (*Juniperus ssp*), Murrizi (*Crateagus spp*) dhe llojet e ndryshme të Qershisë (*Prunus ssp*) në formë të shkurreve

2.2.4.Vendbanimi

Komuna e Mamushës është një komunë e karakterit rural që ka vetëm një vendbanim të përbërë nga nëntë lagje. Madhësia e zonës së vendbanimit është rreth 117 ha ose 11% të territorit të përgjithshëm të komunës. Komuna e Mamushës është zhvilluar në mënyrë lineare përgjatë rrugës kryesore / rajonale i cili është një terren i rrafshët. Analizat tregojnë tendenca të zgjerimit në zonën veriore dhe juglindore, dhe në terrene të pjerrëta në veriperëndim të zonës së komunës duke shkaktuar humbjen e tokës bujqësore.

Kjo zonë është e përbërë nga përdorimet e mëposhtme; banimi, institucionale, administrative, sociale, kulturore dhe ekonomike. Përdorim për banim është i përbërë kryesisht nga shtëpitë individuale të tipit të shkëputura të rrethuara nga hapësira oborri që përdoren me qëllime të tjera, të tilla si, bujqësi, bagëti dhe deponim. Përdorimet e tjera të tokës së pranishme në këtë zonë janë; përdorimet institucionale, administrative dhe kulturore që janë të përqendruara kryesisht në pjesën qendrore të vendbanimit. Përdorimi ekonomik përfshin dyqane të shitjes me pakicë, shërbime, të cilat janë të vendosura kryesisht përgjatë anës së rrugës kryesore/rajonale si një përdorim i vetëm ose i kombinuar me përdorim të banimit, dhe përdorimi industrial që përfshinë aktivitete të rënda dhe të lehta prodhuese.



Foto 1.Mamusha-Qendra

Foto 2. Lagje e Mamushës

Një tjetër përdorim janë infrastruktura rrugore , infrastruktura e komunikimit dhe shërbimet publike, si dhe parqet, zonat e gjelbra dhe rekreative.Për shkak të karakterit rural të vendbanimit në këtë zonë brenda parcelave janë të pranishme gjithashtu dhe pjesë të tokës për kultivimin e perimeve dhe frutave për qëllime familjare dhe të biznesit.Lidhur me pronësinë e tokës kjo zonë është e përbërë nga toka në pronësi të individëve private që mbulon përqindjen më të lartë të zonës dhe komunës.Toka në pronësi private në këtë zonë është e madhësive të ndryshme ku madhësia minimale e parcelës është rreth 40.0 m² dhe maksimale është 20.000 m².Toka që është në pronësi komunale është në përqindje më të vogël dhe gjendet në një vend potencial për zhvillimet e ardhshme për përdorim të komunitetit



Foto 3: Mamusha ne harten e Kosovës




Foto 4:Pozita gjeografike

2.2.5. Popullsia e Mamushës

Regjistrimi i fundit i popullatës ishte bërë më 2011, për herë të parë për Mamushën si një komunë në vete. Në mënyrë që të krijohet një ide e evoluimit të vendbanimeve në kuptimin e rritjes së populates ndër vite, në tabelën e mëposhtme janë prezantuar të dhëna nga viti 1945 deri më 2011.

Megjithatë, siç tregon tabela ka një rritje konstante të popullsisë. Nga të dhënat në tabelën 1. Popullata prej vitit 1948-1953 është rritur për 11% (përafërsisht 2.2 % në vit), nga vitet 1953-1961 është rritur 6% (ose përafërsisht 0.75% në vit), nga 1961-1971 është rritur për 28 % (ose përafërsisht 2.8% në vit), nga viti 1971-1981 është rritur 35% (përafërsisht 3.5% në vit) dhe prej vitit 1981-1991 popullata është rritur për 20% (përafërsisht 2% në vit). Megjithatë, nga viti 1991 deri në vitin 2011 numri i popullatës është shtuar për 67 % (ose 3.35% në vit). Nga të dhënat e mësipërme mund të shihet se rritja më e madhe e popullsisë ishte në periudhën mes viteve 1991-2011.

Tabela 1.Rritja e popullsisë ndër vite

Popullsia e komunës së Mamushës								
Viti	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2010	2011
Nr.banorve	1.352	1.500	1590	2.038	2.752	3.297	4.234	5.507

2.2.6.Dendësia e populates

Sipërfaqja e përgjithshme e territorit të komunës së Mamushës është 10.94 km² me dendësi të popullatës prej 503.4 banorë në /km² (e llogaritur për numrin e popullatës të nxjerrë nga Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë më 2011). Kjo shifër tregon se dendësia e popullatës në Mamushë është më i lartë se dendësia mesatare në Kosovë, që është (177.4 banorë /km²)5.

Tabela 2. Numri I ekonomive familjare

Ekonomite familjare ne komunën e Mamushës								
Viti	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2008	2011
Ekon. familjare	183	198	209	220	263	334	403	566

Popullsia në bazë të përkatësisë etnike: Komuna e Mamushës është e banuar kryesisht nga tri përkatësi etnike , prej të cilëve 93% janë Turq , 6% Shqiptarë dhe 1% Romë, Ashkali apo Egjiptas

2.3.Situata socio-ekonomike

2.3.1.Punësimi dhe papunësia

Në komunën e Mamushës numri i përgjithshëm i popullsisë në moshë pune (15 deri 64 vjet) është rreth 3440, numri i popullatës ekonomisht aktive është rreth 1216, prej të cilëve 97% janë të punësuar, 1.1% ka punuar por tash është e papunë , 0.7% e papunë dhe nuk ka punuar kurrë , 0.9% e papunë duke pritur që të filloj punën, përderisa numri i popullatës ekonomisht jo aktive është rreth 2224 apo 65% e numrit të përgjithshëm të moshës së punës.

2.3.2.Barazia gjinore

Popullata ekonomisht joaktive përfshin gratë e te gjitha moshave të cilat kujdesen për shtëpinë apo familjen. Kjo është si rezultat i të qenurit një komunë rurale, ku mundësitë e punësimit kanë bazë kryesisht familjare (në bujqësi dhe bizneset e ndërlidhura me bujqësi) pothuajse të gjitha femrat anëtarë të moshës së punës nuk janë zyrtarisht të punësuar , dhe në vend të kësaj marrin detyra në kuadër të ekonomisë familjare dhe aktiviteteve shtesë në ferma. Kjo qon në një pabarazi të gjerë ndërmjet gjinive në lidhje me fuqinë punuese se sa që perceptohet në nivelin e Kosovës.Sa i përket popullatës ekonomisht jo aktive, 18% e vijojnë shkollën dhe pjesa tjetër është e pensionuar ose nuk punon për arsye tjera. Duke marrë parasysh se Mamusha është një komunë e re, shërbimet shëndetësore dhe arsimore janë të kënaqshme, por ende është e nevojshme që të pun. ohet për avancimin e vazhdueshëm të këtyre shërbimeve dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit. Në aspektin e arsimit në komunë ka një përqindje më të ulët të vajzave që frekuentojnë shkollën në krahasim me djemtë Kështu që avancimi i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore si dhe inkurajimi i vajzave të vijojnë shkollimin do të jetë njëra nga sfidat e Mamushës

2.3.3.Sherbimet publike

Sa i përket Shërbimeve Administrative Komunale, Një zyre e regjistrimit civil është hapur në ndërtesën komunale më 22 Maj 2009. Së bashku me certifikatat e lindjes , banorët tashmë mund të marrin edhe dokumente tjera personale siç janë

letërnjoftimet dhe pasaportat. Ofrimi i shërbimeve si regjistrimi i automjeteve dhe dhënia e patentë shoferëve nuk ka filluar ende .

2.3.4.Organizimi i shoqërisë civile:

Komuna e Mamushës ka disa Organizata Joqeveritare (OJQ) apo shoqatat që kryesisht merren me aktivitete politike, kulturore, arsimore, bujqesore dhe të zhvillimit ekonomik. Disa nga Organizatat e Mamushës janë “ Shoqata Kulturore Artistike “Asik Ferki” , Shoqata Rinore “ Alperenler”, Shoqata për arsim dhe kultur “ Shoqata e Fermerëve”, Shoqata e afaristëve” dhe Shoqata Kulturore Artistike “ Asik Ferki

Mediat lokale: nuk ka radio apo TV kanale lokale në komunën e Mamushës apo ndonjë gazetar që i shërben medias lokale. Prandaj, popullata kryesisht informohet nëpërmjet medieve publike dhe private të Kosovës.

2.3.5.Situata Sociale

Mamusha ka 566 ekonomi familjare me ç’rast më tepër se 40% e ekonomive familjare kanë më shumë se 10 + anëtarë. Një fakt që duhet theksuar është se rreth 21% të ekonomive familjare në Mamushë bien nën shifrat e mesatares së (mesatarja e ekonomive familjare të Kosovës (MEFK) që është 5.85 anëtarë) dhe ky është një trend në rritje.

2.3.6.Shkalla e varfërisë dhe asistencës sociale

Në komunën e Mamushës është themeluar kohëve të fundit Zyra për mirëqenie sociale nën Departamentin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Njësia përbëhet nga një koordinator dhe një zyrtar. Niveli i varfërisë, është përcaktuar në bazë të numrit të familjeve që marrin asistencë sociale, e cila ende jepet nga komuna e Prizrenit. Të dhënat e marra nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale tregojnë se në vitin 2011 rreth 22 familje kanë marrë ndihmë sociale. Bazuar në numrin e familjeve që marrin asistencë sociale është vlerësuar se norma mesatare e varfërisë në komunë është 4.0%.

2.3.7.Shëndetësia:

Që nga Janari i vitit 2007 kujdesi shëndetësor parësor i Mamushës është ndarë nga kujdesi shëndetësor parësor i Prizrenit. Tani, kujdesi shëndetësor parësor në Mamushë menaxhohet nga Departamenti Komunal i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet në Qendrën kryesore të Mjekësisë Familjare, e cila ndodhet në qytetin e Mamushës.

Ndërtesa e Qendrës së parë të Mjekësisë Familjare u ndërtua në vitin 2002 nga KFOR-i Turk. Në fund të vitit 2008 Qendra e re e Mjekësisë Familjare u bë funksionale, ndërtimi i së cilës u financua nga Ministria e Shëndetësisë.

Qendra ka të punësuar gjithsej 17 punonjës, duke përfshirë një mjek specialist, dy mjekë të përgjithshëm, një dentist, një teknik i lartë, një teknik i farmacisë, dy teknik laborator, 6 infermiere/ teknikë medicinal dhe dy punonjës administrativë. Qendra është e hapur nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 9 të mbrëmjes dhe ofron shërbime të kujdesit shëndetësor parësor të përgjithshëm, shërbime laboratorike, dentare dhe vaksinim ndërsa për shërbimet e kujdesit shëndetësor dytësor, banorët i drejtohen Spitalit Rajonal të Prizrenit

Rekomandime:

- Fushatë informative,seminare,trajnime ne lidhje me perfitimet nga arsimi
- Trajnime profesionale për vetpunësim dhe krijimin e vendeve te punes
- Inkurajimi I grave të vazhdojnë arsimin e larte dhe të angazhohen në aktivitete publike dhe te vetpunesohen
- Inkurajimi I themelimit te shoqatave të grave në komunë
- Zgjerimi I kapaciteteve të qendrës shëndetësore,me gjinekologji dhe obstetrikë.

2.3.8.Arsimi

Sistemi arsimor në komunën e Mamushës është i organizuar në tre nivele: parashkollor, fillor, mesëm i ulët dhe mesëm i lartë, të cilat nivele zhvillohen në dy objekte shkollore. Sistemi i arsimit menaxhohet nga Departamenti Komunal i Arsimit.

Niveli i parashkollor (çerdhe), Në komunë e Mamushës nuk ka çerdhe për fëmijët deri në 4 vjeç, Komuna duhet të merr në konsiderim sigurimin e objektit apo hapësirës për kopsht. *Niveli parashkollor* që nga Shtatori i vitit 2010 këto klasë janë vendosur në objektin e shkollës së re “Haci Ömer Lütfü”. Mësimi zhvillohet në gjuhën turke dhe gjuhën shqipe, ku rreth 15% i femijeve mesojne ne gjuhen Shqipe dhe te tjeret ne gjuhen Turke.

Niveli fillor dhe mesëm i ulët, Deri ne vitin akademik 2009/2010 si shkollë fillore ka qenë shkolla “Haci Omer Lutfu”, por që nga Shtatori i vitit 2010 mësimi mbahet në objektin e ri të shkollës fillore “Haci Ömer Lütfü”. Në këtë shkollë zhvillohet arsimi fillor dhe i mesëm i ulët, ku rreth 92% mesojne në gjuhën Turke kurse te tjeret në gjuhën Shqipe.Shkolla ka 29 mësimdhënës për lëndët në gjuhën turke (si komunitet shumicë në komunë), gjë që nuk plotëson kriteret për raportin nxënës mësimdhënës, ndërsa për mësimin në gjuhën shqipe (si komunitet pakicë në komunë) janë 14 arsimtarë, që plotëson kriterin 14.2 nxënës/1 mësimdhënës.

Niveli i mesëm i lartë, Shkolla e nivelit të mesëm në Mamushë “Ataturk” filloi të funksionojë në vitin 2002 dhe ka 2 degë, në degën e shkencave natyrore dhe atë të shkencave shoqërore. Shkolla u ndërtua nga KFOR-i Turk në vitin 2003 dhe ka 5 klase ku mësimi mbahet në gjuhën turke. Në këtë shkollë zhvillohet mësimi i arsimit të mesëm të përgjithshëm (gjimnazi) dhe mjekësor si pjesë e shkollës së mesme të mjekësisë të Prizrenit. Shkolla ka 7 mësimdhënës, që plotëson kriterin për raportin nxënës/ mësimdhënës. Personeli i shkollës është i përbërë nga punonjës nga Mamusha dhe atyre që vijnë nga komuna fqinje e Prizrenit. Duke pasur parasysh kualifikimin rreth 46% (shumica) janë me diplomë të shkollës së mesme, 36% janë me shkallën e 4 vjet universitet, rreth 4% janë me diplomë Bachelor.

Tabela 3. Numri I nxënësve dhe niveli I arsimit

Nr.	Niveli	Numri i nxënësve		
		Femra	Mashkuj	Totali
1	Parashkollor	24	36	60
2	Fillor	442	454	896
3	I mesëm	66	97	163
4	Fënijtë me nevoja të veqanta	3	2	5
	Gjithsejt			1124

Analfabetizmi: Sa i përket analfabetizmit ,të dhënat e marra nga regjistrimi i popullsisë në Kosovë të vitit 2011 tregon se rreth 1.3% e popullsisë së moshës 10 vjeçar dhe më të mëdhenj nuk dinë shkrim dhe lexim e cila është më e ulët sesa përqindja e Kosovës e cila është 3.8%. Përqindja më e lartë e analfabetizmit është e pranishme tek popullsia në mes të moshave 60 deri në 79 vjeç.



Foto 5.Qendra e Mmjeksisë Familjare Foto 5.ShF. “Haci Omer Lutfu”,

Rekomandime;

- Zgjerimi I kapaciteteve të shkollës së mesme
- Ndërtimi I qendrës rinore
- Sigurimi I pajisjeve të teknologjisë së re në arsim dhe shëndetësi
- Hapja e radio stacionit local
- Ofrimi I shërbimeve telefonike për kujdesin ndaj të moshuarve dhe njerëzve me nevoja të veqanta

2.4.Hapësirat publike

2.4.1.Parqet



Foto 7.Parku Ankara



Foto 8.Parku buz Lumit

2.4.2.Fushat sportive

Në Mamushë sporti më i popullarizuar është futblli. Komuna ka tre terene të hapura të sportit, dy janë terene të futbollit dhe një I basketbollit. Njëri nga terenet e futbollit që ndodhet ndërmjet Shtëpisë së Kulturës dhe Shkollës së re fillore, është ndërtuar menjëherë pas luftës. Kurse dy tjerat janë ndërtuar në

të një njëjtën kohë me objektin e shkollës së mesme të lartë në vitin 2002 nga KFOR-i Turk. Aktualisht nuk ka terene të mbyllura të sportit. Tereni i futbollit dhe i basketbollit brenda oborrit të shkollës përdoret nga nxënësit e shkollës dhe gjatë pushimeve përdoret nga rinia. Megjithatë, këto terene janë të kualitetit të ulët dhe kërkojnë përmirësime. Për më tepër, për shkak të përdorimit të shpeshtë nga ana e qytetarëve tereni i futbollit afër shtëpisë së kulturës dhe shkollës është në gjendje të keqe. Për të përmirësuar gjendjen e tereneve dhe për të plotësuar nevojat e qytetarëve, Kuvendi Komunal ka filluar me punët regjeneruese.

Në kuadër të punëve regjeneruese komuna e Mamushës ka filluar të hartoj projektin për terenet e hapura dhe të mbyllura të standardit Europian. Tereni i futbollit në të hapur ndodhet afër Shtëpisë së Kulturës. Realizimi I këtij tereni është financuar nga Ministria e Komuniteteve dhe për Kthim. Aktualisht vetëm ky teren është përfunduar. Kurse tereni i mbyllur i sportit do të financohet nga Komuna Turke Büyükçekmece. Realizimi i këtyre dy projekteve do të rris kualitetin e jetës së qytetarëve, pasi që në Mamushë nuk ka salla të gjimnastikës nëpër shkolla dhe në përgjithësi ka mungesa hapësirave publike. Mirëpo rekomandohet që të ndërtohet salla për lloje të ndryshme të aktiviteteve sportive.

2.5.Trashëgimia kulturore

2.5.1.Monumentet kulturore

Institucioni i vetëm kulturor në Mamushë është shtëpia e kulturës e cila është përdorur për shumë qëllime multi për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe si një librari.

Në komunën e Mamushës ka disa monumente të trashëgimisë kulturore të trashëguara nga e kaluara, si: Kulla e Sahatit që është e zyrtarisht nën mbrojtje, Varrezat Historike Osmane, dhe shtëpitë historike më tepër se 100 shtëpi të vjetra. Kulla e Sahatit dhe varrezat Osmane nuk përdoren dhe si rezultat janë dëmtuar. Kurse, shtëpitë janë të banuara nga pronarët, por kanë nevojë për restaurim. Komuna e Mamushës përnafshon restaurimin dhe rehabilitimin e kullës dhe varrezave për të shtuar vlerën dhe me këtë t'i tërheq turistët.

2.5.2.Sahat Kulla – Kulla e Sahatit

Sahat Kulla ndodhet në Mamushë dhe sipas kalendarit islamik u ndërtua në vitin 1230 nga Mahmut Pasha. Pasha e ndërtoi kullën e sahatit me qëllim që t'i tregonte orën fshatrave përreth. Pasi u përdor për një kohë të gjatë, kambana u çua diku tjetër. Aktualisht kulla e sahatit është jashtë përdorimit dhe si rezultat

është dëmtuar. Por sahati është nën mbrojtjen e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Komunën e Prizrenit.

2.5.3.Varrezat historike

Varrezat historike ndodhen në pjesën jug-lindore të Mamushës. Kjo varrezë është rreth 300 vjeçare. Ajo l ka mbetur banorëve të Mamushës nga Osmanët. Komuna e Mamushës ka filluar hartimin e projekteve me qëllim përmirësimin e kësaj varreze të vjetër dhe të pa-mirëmbajtur.



Foto 9:Sahat Kulla



Foto 10: Shtëpi e vjetër

2.5.4.Shtëpitë Historike

Edhe pse tashmë kanë mbetur në numër të vogël, shtëpitë historike i ruajnë ende vlerat historike. Vetëm 2-3 shtëpi kanë mbetur nga 100 shtëpitë e vjetra. Këto shtëpi janë ndërtuar me qerpiç dhe kanë nga dy kate. Pronësia e shtëpive është private dhe përdoren për banimit. Shtëpitë nuk janë nën mbrojtjen e institucioneve përkatëse dhe nuk janë të mirëmbajtura.

2.5.5.Festivalet

Për më tepër, si ngjarje me rëndësi kulturore është “ Festivali i Domates” që festohet që nga viti Korriku i vitit 2009. Qëllimi i festivalit është mbledhja e prodhuesëve dhe tregëtarëve nga Kosova dhe shtetet e regjionit si dhe promovimi i industrisë së domates në Mamushë. Festivali është mjaft popullor ku zhvillohen vallëzimet tradicionale.

Rekomandime:

- Rahabilitimi I Sahat Kullës
- Varrezat Osmane të futen ne listen e trashëgimisë kulturore
- Rregullimi I shtegut shpirtëror
- Krijimi I shtigjeve për këmbëssor dhe qiklizëm në rrugët kodrinore dhe përgjat lumit.

2.6.Infrastruktura publike

Komuna e Mamushës shtrihet në regjionin jugor të Kosovës. Vendbanimi i vetëm në komunë është e komuna e Mamushës që gjendet në të dy anët e rrugës që lidh rrugën Piranë – Suharekë me rrugët regjionale Prizren-Prishtinë dhe Prizren – Shkup, ndërsa në jug lidh me Gjakovën dhe Pejën.Distanca nga qendrat e komunave fqinje është: nga Prizreni është 20 km, nga Suhareka është 10 km dhe nga Rahoveci 15 km.

2.6.1.Llojet e rrugëve

Në Komunën e Mamushës janë tri lloje rrugësh: kryesore/regjionale, lokale, dhe rrugë fushore.Gjatësia e rrugëve urbane është 12.6 km .

Rruga kryesore(regjionale) e ashtuquajtur rruga kryesore e Mamushës e ndan Mamushën në dy pjesë, si një vendbanim linear. Ajo është e gjatë 3.42 km, dhe ofron qasje në dhe nga rrugët e parapara me kapacitet më të madh dhe shpejtësi më të madhe. Kjo rrugë është asfaltuar dhe shtruar gjatë vitit 2008 nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit. Meqë ajo e lidh Piranën me Suharekën shpesh është shumë e ngarkuar me trafik.

Rrugët lokale janë rrugë që lidhin lagjet dhe shtëpitë brenda vendbanimit të Mamushës. Gjatësia e rrugëve periferike është 11.63 km. Shtrimi i këtyre rrugëve është mbështetur nga IOM-i gjatë vitit 2007 dhe pjesa tjetër nga vet bugjeti komunal, të cilat kryesisht janë shtruar me kubëza të betonit.

Rrugët fushore sigurojnë qasje në ara dhe zonën rurale të komunës dhe gjatësia e tyre është rreth 30 km. Këto rrugë nuk janë të asfaltuara apo të rehabilituara sepse ekziston problem i pronësisë që duhet zgjedhet nga Komuna.

Tabela 4.Infrastruktura rrugore e Mamushës

Rrugët e Mamushës			
Kategoria	Klasifikimi I rrugëve sipas hapësirës		
	Te asfaltuara	Të pasfaltuara	Gjithsejt

	km	Km	Km
Regjinale/kryesore	12.6	0	12.6
Lokale	5.67	5.96	11.63
Fushore	0	30	30

2.6.2.Trotuaret

Rruga kryesore ka trotuare të shtruara, që tregon që ka siguri për këmbësorë. Disa rrugë periferike kanë gjithashtu trotuare, por në shumë rrugë kjo çështje nuk është adresuar dhe duhet mirret në konsiderim gjatë fazave të ardhshme.Totali i trotuareve të shtruara në Mamushë është 10 kilometra.Nga kjo gjatësia e trotuareve me kubeza është 4 kilometra,kurse trotuaret tjera jane te pa shtruara .

2.6.3.Vend parkingjet

Në Mamushë janë vend parkingjet e kufizuara para objekteve publike, dhe për këtë paraqitet kërkesa për vend parkingje më të organizuara. Shumë nga automjetet parkohen në trotuare,që shkakton rrezik për lëvizjen e këmbësorëve.Ne mamushë ekzistojne vetëm tri vendparkingje për ndalejn e autobusëve,përgjatë rrugës kryesore.

Prioritet për vendosjen e vend parkingjeve duhet të jetë përgjatë rrugës kryesore dhe para objekteve publike.



Foto 11.Rrugët e mamushës



Foto 12.Trotuaret

2.6.4.Transporti publik

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 98 % udhëtojnë brenda Mamushës, ndërsa 2 % jashtë Mamushës. Për transport kryesisht përdoren autobusët nga Mamusha për në Prizren vetëm nga e hëna deri të premten me 3 ndalesa/1 km. Janë dy kompani private që veprojnë në Mamushë. Gjatë ditëve të fundjavës nuk

qarkullon asnjë autobus. Në Mamushë ka dy vend ndalesa kryesore të autobusëve përgjatë rrugës kryesore por nuk ka stacion të autobusëve.

Një numër i vogël i njerëzve përdorin autobusin që tregon që njerëzit nuk udhëtojnë shumë dhe punojnë kryesisht në Mamushë. Bicikleta dhe motoçikleta përdoren nga një numër i vogël i njerëzve që tregon se ka mungesë të shtigjeve dhe materialeve kualitative për shtrim të rrugës dhe kjo çështje duhet adresuar në fazat e ardhshme.

Përfundimisht, transporti hekurudhor nuk përdoret për shkak të pozitës së Mamushës që nuk ka qasje të drejtëpërdrejtë dhe se aktualisht hekurudha nuk funksionon në këtë regjion.

Mamusha lidh Suharekën me Piranën në drejtimin Prizren, Gjakovë dhe Pejë dhe anasjelltas në drejtimin Prizren – Prishtinë dhe Shkup.

Rekomandime:

- Ndërtimi i rrugës Mamushë -Tërrnje
- Ndërtimi i rrugës Mamushë- Reti
- Rehabilitimi i rrugës Mamushë –Prizren
- Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës Mamushë- Novakë
- Mirembajtja e rrugëve lokale dhe ndërkomunale
- Rehabilitimi i rrugëve dytësore
- Hapja dhe shtrimi i rrugëve fushore me zhavor
- Zgjatja e trotuareve
- Ndërtimi i stacionit të autobusëve
- Ndërtimi i shtegut për biciklista

2.6.5.Rrjeti elektrik

Mamusha furnizohet me energji elektrike nga Suhareka me një kapacitet prej 10KV. Ka shtat (7) transmetues të energjisë elektrike me kapacitet 200KË dhe tre (3) transmetues të energjisë elektrike me kapacitet 400KË . Sipas nje ankete që është bërë në teren, 60.0% të objekteve janë të kyçura në sistemin e energjisë elektrike, ndërsa 4.0% nuk janë të kyçura ndërsa për 36.0 % nuk ka informata.

Rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike është relativisht i vjetruar dhe përbën një problem të madh gjatë sezonit të dimrit. Në përgjithësi konsumimi i energjisë elektrike nuk paguhet në komunë, gjë që gjithashtu rrit ndërprerjet e energjisë elektrike.Problem akut në komunë paraqet,sepse aktualisht transmetuesit elektrikë janë të vendosure në qendër të vendbanimit gjë që paraqet rrezik për qytetarët, prandaj kjo çështje do të trajtohet sa me shpejt nga komitetet,në fazat e mëtejshme.

2.6.6.Ndriqimi publik

Momentalisht në komunën e Mamushës janë të shtruara 9 kilometra ndriqim publik në të dy anët e rrugës gjë që e bën këtë komunë një ndër komunat që thua se e ka të zgjidhur qeshtjen e ndriqimit natën.

2.6.7.Furnizimi me ujë të pijshëm

Burimet e ujit në Komunën e Mamushës janë të shumta. Mamusha furnizohet me ujë të pijshëm nga dy rezervarët që gjenden në pjesën veri - lindore të komunës. Rezervarët furnizohen me ujë nga dy burime që gjenden në pjesën perëndimore dhe lindore të Mamushës. Rezervarët mbajnë 300.000 Litra dhe 150.000 Litra. Rrjeti i furnizimit me ujë është themeluar nga ATBNZh-ja në vitin 2005 dhe i furnizon të gjitha ndërtesat me ujë të pijshëm. Sipas zyrtarëve komunal, sasia e ujit i plotëson nevojat e qytetarëve të Mamushës. Rezervarët janë të furnizuar me pompa ujore të cilat punojnë me elektricitet. Sipas testeve kimike të bëra më 17.03.2010 kualiteti i ujit në rezervar i plotëson standardet përkatëse

2.6.8.Rrjeti i kanalizimit

Mamusha ka një rrjet të kanalizimit dhe shumica e shtëpive janë të lidhura me të. Sistemi nuk ka fabrikë lokale për trajtim të ujërave të zeza, kështu që një pjesë derdhet në lumin Toplluhë, ndërsa pjesa tjetër është e lidhur me sistemin e fshatit Medvec (komuna e Prizrenit). Plani sugjeron ndërtimin e një fabrike për trajtimin e ujërave të zeza të kapacitetit të vogël me financim nga donatorët dhe lokacioni është rekomanduar të jetë afër pikës së shkarkimit të mbeturinave, përkatësisht në kryqëzimin e dy lumenjve. Plani gjithashtu synon riaftësimin në të ardhmen të gypave të dëmtuar (sipas nevojës) dhe zgjerimin e sistemit të kanalizimit për lidhjet në të ardhmen. Sa i përket sistemit të ujit të shiut koncepti i zhvillimit hapësinor rekomandon ndërtimin e tij përgjatë rrugëve rajonale dhe lokale.

2.6.9.Mbeturinat

Grumbullimi i mbeturinave bëhet nga kompania private I & S. Ekziston një deponi mbeturinash informale por e pa menaxhuar në komunë e cila shkakton ndotje në mjedis. Kohëve të fundit Komuna ka larguar njëërën prej ish deponive, ku është nevojitur që të bëhet ndërtimi i tregut.

Në komunën e Mamushës momentalisht janë të vendosura 209 kanta statike te mbeturinave.

Poashtu për secilën familjë janë dhuruar 615 kanta me kapacitet 70 litra për hudhjen e mbeturinave.Ndërsa në vendë të caktuara publike janë vendosur 10 kontenjer 1.1 për grmbullimin e mbeturinave .



Fot 13. Hudhja e mbeturinave në vende publike



Foto 14. Mbeturinat në lum

Rekomandime

- Rehabilitimi I rrjetit ekzistues të kanalizimit
- Zgjerimi I rrjetit të kanalizimit për zhvillime të reja
- Ngritja e rrjetit të kanalizimit për ujëra atmosferike
- Hartimi I planit për trajtimin e mbeturinave të ngurta
- Ndërgjegjësimi për riciklimin e mbeturinave
- Themelimi I kompanisë publike për menagjimin e mbeturinave

2.7.. Zhvillimi ekonomik

2.7.1. Situata ekonomike

Në komunën Mamushë niveli i papunësisë në kuadër të ekonomisë aktive të popullsisë është më e ulët se sa në nivel kombëtar e cila është rreth 45%²⁷.

Kjo i atribuohet nivelit të lartë të 'vetëpunësimit' të banorëve në sektorin e bujqësisë. Shumica e aktivitetit ekonomik të Komunës zhvillohet nga prodhimtaria bujqësore dhe nga industria që ka të bëjë me bujqësinë. Megjithatë për momentin ka pak investime në këta sektorë të rëndësishëm për të nxitur zhvillimin.

Mamusha ka lidhje me komunat simotra në Turqi dhe Agjencia Turke për bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (TIKA) gjithashtu ka ofruar mbështetje të konsiderueshme për zhvillimin e ekonomik duke bërë përmirësime të infrastrukturës në Komunë siç janë rregullimi i rrugëve dhe trotuareve dhe kompletimi i shkollës së re fillore.

2.7.2. Sektorët e punësimit: Si një komunë rurale, industria bujqësore dhe nga industria që ka të bëjë me bujqësinë, janë kryesisht sektorët e vetë-punësimit.

Megjithatë ka edhe sektorë të punësimit në në komunën e Mamushës. Sektori më i madh i punësimit është bujqësia dhe industria, që ka të bëj me bujqësinë e ku rreth 55.0% e pozitave të punësimit janë të ofruara nga ky sektor.

Tabela

Resorët kryesor të punësimit	Totali (%)
Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria	55.0
Industria perpunuese	3.5
Ndërtimi	13.4
Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i motoreve, automjeteve dhe motocikletave	15.8
Hotelet dhe restorantit	1.0
Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	1.5
Ndërmjetësimi financiar	0.3
Pasuritë e patudshme, dhënja me qera dhe aktivitete biznesore	0.5
Adminstratë publike, mbrotja dhe sigurimi social	3.9
Shëndetësia dhe puna sociale	1.0
Komuniteti tjetër social dhe aktivitetet ppersonale të shërbimit	1

2.7.3. Tregtia

Ekziston edhe një sektor aktual (kryesisht komercial) privat i punësimit i cili mbulon rreth 29% që është tregtia. Kjo është e orientuar drejt biznesit të vogël, me anketimin e bizneseve komercial në përgjithësi punësojnë më pak se 10 të punësuar. Primare për sektorin e biznesit të vogël është në tregtinë dhe shitjen e vajrave motorike dhe pjesët e automjeteve, të cilat janë të importuara kryesisht nga Turqia.

Sektorin publik punëson rreth 10% duke përfshirë edhe vetë komunën, qendrën e shëndetit publik, postë, shkolla, stacionin e policisë dhe në shërbimin e zjarrfikësve. Megjithatë, sipas të dhënave komunale, disa pozicione të sektorit publik janë të mbushur nga të punësuarit që jetojnë jashtë Komunës, kryesisht nga Prizreni.

Përveç tregtisë dhe veprimtarisë bujqësore, sektori i biznesit të vogël është i pranishëm edhe në Mamushë, duke u marrë me aktivitete të ndryshme. Sidoqoftë, tregtia bazohet në tregtinë e vajrave motorike dhe pjesëve të automjeteve të cilat kryesisht importohen nga Turqia, si dhe prodhimeve bujqësore të prodhuara në Mamushë. Koncepti propozon lokacionin e ardhshëm

për zhvillimin e veprimtarive tregtare që të jetë përgjatë rrugës rajonale / kryesore.

Në mënyrë që të përmirësohet zhvillimi i tregtisë, Komuna ka zbatuar projektin për ndërtimin e tregut dhe do të vazhdojë me ndërtimin e një depoje të ftohtë (frigorifer). Për ndërtimin e këtij frigoriferi 95% e mjeteve janë siguruar nga Komisioni Evropian dhe 5% nga buxheti i komunës. Ky objekt do të jetë i një rëndësie të madhe për bujqit e Mamushës.

Aktualisht në Mamushë industria si biznes privat është zhvilluar në një masë të vogël. Disa fabrika si mullinjtë, prodhimi i bllokave të betonit dhe gypave, xhamave të automjeteve si dhe kutive të drurit janë duke funksionuar, ndërsa fabrika e qeseve nuk është duke funksionuar.

Plani rekomandon mirëmbajtjen e fabrikave ekzistuese, por propozon të ndërmarrë masa parandaluese për të reduktuar ndikimin e tyre negativ në mjedis. Sipas planit, si vend potencial për zhvillimin e agro-industrisë së lehtë, përveç tokës së NSH-së, është propozuar të zona jugore e territorit të komunës.

Vendi për aktivitetet e ardhshme industriale është përcaktuar sipas kritereve të zonave të përshtatshme lidhur me mjedisin natyror dhe afërsinë me transportin dhe infrastrukturën. Minimizimi i ndonjë konflikti të mundshëm midis aktiviteteve industriale dhe zhvillimin në të ardhmen për të ruajtur burimet natyrore dhe zonat bujqësore, dhe duke pasur parasysh koston optimale operacionale e që janë thelbësore. Si masë për zvogëlimin e trazirave mes shfrytëzimit të hapësirës për veprimtari industriale apo banim, plani rekomandon krijimin e një tampon zone mes këtyre dy mundësive.

2.7.4. Bujqësija:

Shumica e fermave merren me kultivimin e kulturave bujqësore, dhe prodhimi kryesor është domatja.

Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë në Kosovë të vitit 2013 tregon se 441 e familjeve (që përfaqësojnë 78% të familjeve) kanë tokë, shumica e tyre i posedojnë ato.

Mamusha është e përbërë nga toka bujqësore me cilësi të mirë që është shumë e përshtatshme për prodhimin e perimeve dhe prodhimit bimor. Mamusha është prodhuesi dhe furnizuesi kryesor i domateve për tërë Kosovën. Të gjithë bujqit e komunës së bashku importojnë 8-10 kg të farës çdo vit nga Holanda, pasi që këto farëra janë më të përshtatshmet për klimën lokale dhe për kushtet e dheut. Cilësia dhe sasia e domates së prodhuar në Mamushë është rritur dukshëm gjatë viteve të fundit, në vitin 2012 janë prodhuar 20250 ton domate. Kjo është arritur si

rezultat i investimeve të bujqve në ngritjen e serrave, aktualisht në Mamushë rreth 170 ha tokë janë të mbuluara me serra. Serrat ofrojnë një ambient të brendshëm për të mbjellat, i cili u reziston të gjitha kushteve atmosferike. MBPZHR e inkurajon këtë dhe synon të bashkë-financojë investimet me 50% grante për blerjen e materialeve/ pajisjeve për serra. Megjithatë, për shkak të shpenzimeve të investimit në serra, për momentin shumica e bujqve po përdorin materiale plastike të cilat duhet të hiqen gjatë muajve të dimrit. Për këtë arsye koha e stinës së prodhimit nuk është zgjatur aq shumë deri më tani.

Kulturat e tjera bujqësore që rriten gjatë stinës në komunë janë trangulli, lakra, pjepri, shalqiri, specat (në pranverë) dhe spinaqi, qepët dhe marulet (në dimër). Bujqit janë duke menduar që të rrisin përdorimin e serrave, veçanërisht ato të llojit me xhama ose Perspex, që këto të mbjella në të ardhmen të japin endimente edhe më të mëdha. Kultivohet edhe gruri dhe bimët foragjere, ndonëse ato janë kryesisht për nevoja personale ose si ushqim për bagëtinë.

Edhe hardhitë kultivohen përgjatë kreshtës më të lartë perëndimore të Komunës.

Tabela 5. Aktivitetet ekonomike të zhvilluara në komunën e Mamushës

Industria që ka të bëjë me bujqësinë	Numri i objekteve	Kapaciteti	Viti i ndërtimit
Mulli (birlik, rizam)	2	1700 ton	1985-1990
Thasë	6	6 milion	2012
Ferma të bagëtive	3	148 kafshë	2012
Feramat e pulave	1	60 pula	2010
Bletari	2	80 koshere	2010
Material ndërtimor			
Prodhim i gypave të betonit	1		1995
Xhama për vetura	1		2007
Punëtori			
Zdruktarë	1		1983
Përpunues të drurit	4		2007-2008
Prodhues të dyerve dhe dritareve nga alumini	3		2002-2010
Prodhimi i makinës për objektet ndarëse	1		1980
Tregtia e automjeteve			
Pjesë për automjete	20		1995-2011
Vajra për automjete	7		1995-2010

Elektricitet për automjete	2		2003-2012
Ushqimore			
Markete	11		1990-2012
Bukëpjekës	3		1990-2012
Mishtore	2		1995-2009
Të tjera			
Barnatore	1		2008
Barnatore bujqësore	4		1995-2011
Tekstili	2		2002-2010
Material ndërtimor	1		2008
Shërbimet publike			
Sholla fillore	1		
Shkolla e mesme	1		
QKFM	1		
Posta	1		
Stacioni i policisë	1		
Stacioni i zjarrfikësve	1		
Komuna	1		
Shtëpia e kulturës	1		
Veprimtari private			
Kafe qajtore	6		2002-2012
Qebaptore	4		2001-2012
Internet cafe	3		2003-2010
Frizerë	5		2002-2012
Servis i automjeteve	6		1995-2011
Elektricitet	2		1995-2003
Shitore e vidhave	1		1993
Servis për goma	2		2005-2010
Pompa të benzinës	5		1993-2008
Shitore për xhama të automjeteve	1		2006
Shitore për instalime uji	3		1994-2002
Shërbime të autobusëve	2		1993-2001

2.7.5. Blegtoria

Në Mamushë vetëm 203 amvisëri mbajnë bagëti të cilat ruhen vetëm për nevoja familjare. Rreth 92% e familjeve posedojnë bagëti dhe lopë, 26% posedojnë shpend, 6% posedojnë hoje bletësh, dhe 3.4 % dele dhe dhi 31. Lopët kryesisht mbahen për qumësht. Ky qumësht i mbulon nevojat e familjeve. Teprica e qumështit shitet në dyqanin e kooperativës lokale "Serdar" e cila e grumbullon të gjithë qumështin në Komunë dhe ua shet blerësve në supermarketet lokale në Prizren. Kjo sasi është rreth 4-5 tonë çdo ditë. Bujqit paguhen sipas kontributit të tyre me litra të qumështit. Megjithatë, me çmimet e tanishme të tregut, dhe me importimin në rajon të qumështit të përpunuar me afat të gjatë përdorimi, kjo nuk është gjithaq fitimprurëse.

Delet kryesisht shiten për mishin e tyre në tregjet lokale të rajonit. Para vitit 1999 numri i deleve ka qenë i lartë, megjithatë, pas luftës konkurrenca e mishit të importuar, mundësia e kufizuar për eksport, bashkë me mungesën madhe të transportit më automjete, të gjitha qojnë në një bllokim faktik të kësaj industrie në Mamushë.

Sygjerime për bujqësinë

Pjesa përfundimtare dhe veri-përfundimtare e territorit të komunës është vend i përshtatshëm për kultivimin e pemëve, si dhe kultivimi i bimëve mjekësore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ofron subvencione për bujqit për kultivimin e drithërave dhe blegtorinë, e cila inkurajon bujqit që të merren me bujqësi dhe si dhe promovon bujqësinë si një pasuri e rëndësishme për zhvillimin ekonomik, jo vetëm e Mamushës, por edhe për të gjitha komunat e Kosovës.

Pasi që interesimi për blegtorinë është në rritje e sipër dhe në komunë nuk ekziston asnjë objekt veterinar, plani rekomandon hapjen e një pike veterinar në mënyrë që të kursehet udhëtimi i bujqve në komunat fqinje.

Përveç kësaj, në mënyrë që të mbështetet veprimtaria bujqësore, Komuna me mbështetjen e donatorëve ka ndërtuar objektin e tregut, ndërsa për ndërtimin e frigoriferit punimet janë duke vazhduar. Gjithashtu sugjerohet zhvillimin e marketingut të produkteve vendore bujqësore përmes aktiviteteve promovuese. Një nga aktivitetet e promovimit i cili tashmë është funksional, është Festivali vjetor i Domateve i cili promovon produktet, e sidomos domatet e Mamushës jo vetëm në rajon, por në tërë Kosovën.

Njëherit duhet gjetur zgjidhje për tokën e NSH-ve (Ndërmarrjeve Shoqërore). Komuna e Mamushës ka rreth 43 hektarë të tokës që janë nën mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Shfrytëzimi i kësaj toke në të ardhmen të

përcaktohet atëherë kur do të zgjidhet çështja e pronës. Megjithatë, toka është një zone potenciale për zhvillimin e ardhshëm të aktiviteteve ekonomike.



Foto 15. Punimi I tokës



Foto 16. Punimi I tokës ne serra

Rekomandime

- Kthimi I tokës të Ndërmarrjes shoqërore në tokë komunale
- Hartimi I strategjisë për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë
- Hapja e degëve profesionale të agro-industrisë, agro-turizmit, bujqësisë etj.
- Hartimi I PRRU-së për zonën ekonomike
- Sigurimi I kushteve të volitshme për zhvillimin e industrisë së lehtë
- Zhvillimi I tregtisë për shtitjen e produkteve bujqësore- blegtorale
- Ndërtimi I tregut dhe magazinimit të ftoftë
- Mbajtja e trajnimeve profesionale për krijimin e mundësive të reja për punësim
- Hartimi I projekteve të infrastrukturës fizike
- Organizimi I trajnimeve profesionale dhe punëtorive për profesionistët e rinj në fusha të biznesit

2.7.6. Turizmi

Mamusha ka një pamje të bukur dhe bujqësia është aktivitet kryesor ekonomik i saj. Këto janë potencialet për zhvillimin e agro - turizmit, ku vizitorët mund të shohin veprimtarinë bujqësore gjatë vizitës së Mamushës. Prandaj, është propozuar që të adaptohen disa shtëpi për të shërbyer si bujtina për vizitorët

(përfshirë fjetjen dhe mëngjesin). Si lokacione potenciale për zhvillimin e agro - turizmit dhe turizmit të gastronomisë janë pjesa qendrore dhe lindore e komunës. Festivali vjetor i domateve është një nga ngjarjet që kontribuojnë në zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve turistike.

Në Mamushë ekzistojnë edhe disa ndërtesa të trashëgimisë kulturore dhe varreza osmane të cilat mund të jenë potencial për zhvillimin e turizmit kulturor. Është sugjeruar riparimi dhe rivitalizimi i shtëpive, sahat kullës dhe varrezave. Sahat kulla mund të shërbejë si një pikë vrotimi mbi qytetin. Këto asete të trashëgimisë kulturore gjenden në qendër të qytetit si dhe në pjesën jugore të komunës. Plani rekomandon përmirësimin e qasjes tek këto ndërtesa dhe ndërtimin e shtegut për tek varrezat osmane.

Përveç kësaj, është rekomanduar hapja e një qendre për informacion turistik në brendi të ndërtesës komunale si dhe organizimin e veprimtarive të ndryshme promovuese. Aktivitetet e turizmit që bazohen në resurset natyrore dhe kulturore janë të lidhura ngushtë me sigurimin e vendeve të punës dhe si shërbimet e duhura përcjellëse por edhe duke pasur parasysh ruajtjen e resurseve natyrore.

Madje, plani inkurajon bashkëpunimin me komunat fqinje sa i përket turizmit

2.7.6.1.Turizmi kulturor:

Ka për qëllim të përdorë elemente të trashëgimisë shpirtërore për t'i dhënë karakter strukturës së mobilitetit brenda komunës.

Aspektet që këtu janë marrë parasysh janë: Xhamia Qendrore, 3 shtëpi të vjetra, Objektet kulturore dhe të tjera publike si Xhamia e Re, Shatërvani, Shkolla fillore "Haxhi OMER LUTFU", Qendra Kulturore, Ndërtesa Komunale, Stacioni i Autobusëve si dhe Hapësirat Publike ;Parku Ankara, Parku i fëmijëve, Parku i ri, si dhe Segmenti i lumit Toplluhë

2.7.6.2.Shtegu i domates:

Shtegu ka si pikënisje ndërtesën komunale dhe si pikë të fundit shkollën fillore "Haxhi OMER LUTFU", si dy vende kryesore për ngjarjet festive. Shtegu shtrihet përgjatë lumit Toplluhë dhe së bashku me tokat bujqësore krijon një sistem që synon të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor.

Është emëruar shtegu i domates pasi ka për qëllim të lidhë dy pikat kryesore ku zhvillohen ngjarjet festivalit të domates, e cila është në rritje çdo vit. Shtegu i tillë do të ketë edhe shëtitore të këndshme, I pasuruar me ngjarjet promovuese, me ç'rast përmirëson qasjen në fusha dhe siguron funksionimin e segmentit të lumit.

2.7.6.3.Shtegu shpirtëror:

I ngjashëm me atë paraprak, ky segment si një pikënisje ka një xhami të re e cila edhe pse nuk është e vendosur në vetë kufirin e komunës, me praninë e saj

paraqet pikënisjen e vendbanimit, kur arrihet nga Komuna e Prizrenit. Duke pasur parasysh se feja është pjesë shumë e rëndësishme e identitetit të Mamushës dhe Xhamia e Re përkujdeset që të zhvillohen aktivitete të përditshme, plani propozon krijimin e një linje që përveç lidhjes me zonën qendrore, ka për qëllim të ofrohet një shëtitore në të cilën do zhvilloheshin aktivitete që mundësojnë socializimin, me fokus të veçantë për të moshuarit.



Foto 17. Kultivimi i domatës



Foto 18. Shtegu shpirtëror

2.7.7. Ekoturizmi

Sa i përket mjedisit, Mamusha ka peizazhe të bukura natyrore, dhe me qëllim që të mbrohet dhe përmirësohet, është rekomanduar që të ndërmerren hapa të rëndësishëm. Për shkak të përbindës së lartë të tokës bujqësore, ajo do të shfrytëzohet si një bazë për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Bile, toka bujqësore veçse ia shton bukurinë komunës. Nga ana tjetër, pasi një pjesë e madhe e zonës është e mbuluar me hapësirë të gjelbër, menaxhimi i duhur i këtyre fushave duhet të promovohet dhe të rritet funksioni në këto fusha. Prandaj, në këto hapësira është propozuar që të shfrytëzohen për aktivitete sportive dhe argëtuese. Në mënyrë që të krijohet një lidhje mes zonave të gjelbra, është rekomanduar ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë.

Edhe lumi Toplluhë, kontribuon në shtimin e bukurisë së pamjes së komunës; kështu që, plani rekomandon përmirësimin e shtratit të lumit dhe të vazhdohet me mirëmbajtjen e tij. Gjithashtu, është rekomanduar krijimi i një korridori të gjelbër përgjatë shtratit të lumit, i cili do të ofronte për qytetarët e të gjitha moshave një hapësirë për shëtitje, ushtrime dhe çlodhje,.

2.7.7.1.Korridoret e gjelbra:

Prania e gjelbërimit përgjatë rrjetit të drejtojë shfrytëzuesin dhe të jap aromë arterieve Brenda vendbanimit.Ky rrjet ka për qëllim t'i japë banorit/ vizitorit / shfrytëzuesit një paralele alternative për të lëvizur brenda komunës e cila do t'i mundësojë dikujt për të treguar për resurset kryesore të Komunës.Segmentet e rrjetit kanë një cilësi dalluese në varësi të karakterit të elementeve që sjellin së bashkute pasuruara me ngjarjet promovuese, me ç'rast përmirëson qasjen në fusha dhe siguron funksionimin e segmentit të lumit.

2.7.7.2.Shtegu i pyllit:

Shtegu i gjelbër shtrihet përgjatë kufirit perëndimor të zonës së vendbanimit, duke përfaqësuar një urë mes pyllit dhe zonës së banuar. Ai synon të ofrojë njerëzve një shëtitore të duhur për çlodhje. Ky segment rrjeti është shoqëruar me një pamje të dendur gjelbërimi. Kjo është bërë me qëllim që të zbus kalimin nga zona e banuar me mungesë të madhe të drunjve në zonë pyjore.

2.7.7.3.Shtegu i lumit:

Pikënisja e këtij segmenti me të vërtetë paraqet pikën hyrëse të Komunës nga Komuna e Suharekës e shënuar me një portë të veçantë. Shtegu plotëson qëllimin e rrjetit duke i dhënë një qasje të menjëhershme në zonën e lumit si një mënyrë alternative e lëvizjes përgjatë komunës paralele për në rrugën kryesore të vendbanimit. Shtegu karakterizohet me një trajtim të veçantë të lumit që do të kontribuonte në ngadalësimin e rrjedhës së lumit drejt zonës së banuar ashtu që të zvogëlohen mundësitë për përmbytje duke shfrytëzuar elementet natyrore të zonës. Ky kombinim do të rezultojë me efekte shumë të këndshme të ujit sa i përket lidhjes me pjesët tjera të lumit, ku do të ketë rrjedhë më të natyrshme e ujit.



Foto 19.Koridoret e gjelbërta

2.7.7.4.Fontanat:

Në pjesën lindore të komunës janë katër fontana (burime) tradicionale. Këto Fontana publike përdoren nga bujqit në zonën përreth,për ujitje te tokave bujqësore. Me rregullimin e tyre dhe pershtatjen e ambientit per pushim dhe rekreacion keto monumente natyrore do te ishin atraksion shumë jishës për turistë si dhe për pushues të fshatit.

Pjesa 3

III. Vleresimi i gjendjes mjedisore

3.1.Ndotja e mjedisit

Është evidente që komuna e Mamushës është duke u përballur me probleme mjaftë serioze në lidhje me ndotjen e mjedisit. Shqetësimet më të mëdha mjedisore janë ndotja e tokës dhe e ujit nga mbeturinat e ngurta, ujërat e zeza, pesticidet dhe plehrat artificiale. Ajrit është i ndikuar edhe nga emetimet e larta të CO2 nga karburantet me cilësi të dobët për ngrohje, trafiku dhe pluhuri. Prandaj, ekziston nevoja e masave për të përmirësuar situatën aktuale dhe për të ngritur kushtet për të shmangur ndotjen e mëtejshme në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e jetesës dhe kushtet natyrore të komunës

Tabela 6.Problemet mjedisore në komunën e Mamushës

Nr.	Problemet
1.	Trajtimi jo adekuat i ujërave të zeza
2.	Derdhja e ujërave të zeza në lumenj
3.	Hudhja e mbeturinave në lumenj
4.	Hudhja e mbeturinave ne vende të huapura pran qendrave të banimit
5.	Mbetjet urbane të pa përpunuara
6.	Deponite ilegale
7.	Mos përfshirja e të gjitha vendeve urbane dhe rurale në grumbullimin e mbeturinave në kontinjer
8.	Prerja pa kriter i pyjeve
9.	Mungesa e strategjisë për ruajtjen e biodiversitetit
10.	Mungesa e strategjisë zhvillimore
11.	Ndërtimi I banimit në toka bujqësore
12.	Mungesa e një zhvillimi të qëndrueshëm në zonën turistike
13.	Mungesa e strategjive për parandalimin e erozionit

3.1.1.Degradimi

Shkaktarë kryesorë i degradimi është derdhja e mbeturinave. Zakonisht degradimi shkaktohet nga mbeturinat e hedhura në mënyrë ilegale në toka të zbrazëta dhe në lumenj. 23% e popullsisë së Mamushës e bën hedhjen e mbeturinave përmes kompanisë përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave, ndërsa 77% e popullsisë i hedh mbeturinat në lumë, etj.

Prerja e drunjëve është prezente edhe në Mamushë, banorët kryesisht presin drunjët për t'i shfrytëzuar për ngrohje si dhe për ndërtimin e serrave. Kjo shkatërron bukurinë e peisazhit dhe çon drejt shpyllëzimit. Njëri nga shkaqet tjera të degradimit është përmytja e lumit Toplluha, që ndodh në Shkurt – Mars. Kjo çon drejt shaktërrimit të shtratit të lumit që ka ndikim negative ndaj Biodiverzitetit në shtratin e lumit. Vërshimet gjithashtu bartin token e punueshme që çon drejt krijimit të tokës jopjellore. Komuna ka filluar të hartoj projektin për përmirësimin e shtratit të lumit dhe rrjedhën e tij në mënyrë që të pengoj këtë dukuri. Por për shkak të mungesës së Planit Zhvillimor të Komunës së Mamushës dhe Planeve Rregulluese Urbane dhe vendimeve për dhënjen e lejeve të ndërtimit, banorët ndërtojnë në tokë bujqësore kryesisht në Veriperëndim të Mamushës. Kjo shkakton humbjen e tokës bujqësore dhe ndërtimin illegal të objekteve.

Masat që duhet ndërmarrë

Andaj me qëllim të ruajtjes së ambientit duhet marrë disa masa nga komuna;

- Trajtimi adekuat e ujërave të zeza
- Kufizimi i zgjerimit të vendbanimeve dhe rregullimi i hapësirës së Mamushës dhe të hapësirave tjera të komunës , që të jenë sa ma tërheqëse për të jetuar
- Minimizimi i ndikimeve të rrezikshme si vërshimet,erërat,zjarret etj
- Mbrojtja e llojllojshmërisë së pejsazheve natyrore
- Ngritja e hapësirave të gjelbër në qytet
- Shfrytëzimi i burimeve të ujit
- Minimizimi i veprimeve të dëmshme të njeriut në mjedis
- Kontrolli i zhvillimit në zonën urbane
- Përparimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm
- Ndërtimi i sistemit të kanalizimit fekale dhe atmosferik
- Rikonstruktimi dhe rigjenerimi i zonave të trashëgimisë historike dhe kulturore
- Mbrojtja e tokës kualitative bujqësore dhe ndalimi i ndërtimit në tokat e kategorisë 1-4.
- Mbrojtja e ndotjes së ajrit nga trafiku dhe prodhimtaria urbane dhe industriale
- Mbrojtja e ujërave nga derdhjet e kanalizimeve ,me trajtime adekuate,ndërtimin e impianteve

3.2.Toka

Komuna e Mamushës shtrihet në rrafshin e Dukagjinit në jug të Kosovës. Mamusha ka kryesisht terren të rrafshët, me tokë cilësore dhe klimë shumë të përshtatshme për bujqësi. Mamusha qendrore kryesisht është e mbuluar me fusha kurse në Veriperëndim janë dy kodra Maçovina dhe Tiçanlliku ku janë mbjellur vreshtat, dhe në juglindje është pylli (kaçuba). Pika më e lartë e komunës është Golubrada me 460m lartësi dhe pika më e ulët është në lartësinë 320 m që ndodhet në jug. Nëpër komunë rrjedhin dy lumenjë Toplluha që është lumi më i madhi dhe që derdhet në lumin Drini I Bardhë dhe lumi më i vogël Tërnja.

Një pjesë e madhe e tokës së Mamushës është e pasur me burime të ujërave nëntokësore që përdoren nga qytetarët për pije dhe për ujitjen e tokës bujqësore. Vendbanimi linear shtrihet mbi shpatije, në qendër të komunës, përgjatë rrugës së ngushtë dhe të gjarpërore. Krahas fushave bujqësore, kodrave, lumenjve peizazhi i komunës është i pasur edhe me ndërtesa të ndryshme kulturore, hapësirat publike ku lidhja dhe kombinimi i këtyre elementeve natyrore dhe kulturore mund të kontribuojnë në zhvillimin e karakterit të komunës përkatësisht vendbanimit. Pjesa më e madhe e tokës në Mamushë ka shumë burime ujore nëntokësore të pasura të cilat janë përdorur nga banorët për të pirë dhe për ujitjen e tokës së punueshme.

3.2.1Përbërja e tokës

Një pjesë e madhe e tokës në komunën e Mamushës me rreth 85% është tokë bujqësore. Nga kjo, 65% është tokë e punueshme e kualitetit të mirë e cila përdoret për të prodhuar perime; 11% janë livadhe dhe kullota dhe rreth 9% janë vreshta; pyjet dhe shkurret përbëjnë 9% të territorit të komunës. Vendbanimi në vetvete shtrihet në tokë bujqësore të kualitetit të mirë të zones qendrore, ndërsa vetëm 2% e tokës komunale është kategorizuar si një tokë joproductive.

3.2.2.Toka bujqësore

Kjo zonë është e përbërë nga tokat e përdorura kryesisht për aktivitete bujqësore /blegtorale e cila mbulon pjesën lindore dhe perëndimore të territorit të komunës; ajo është e vendosur në një lartësi prej 320 – 460m. Zona është me potencial për zhvillimin e aktiviteteve të tjera të tilla si rekreacioni, turizmi bujqësor, hapësira publike si dhe kultivimin e pemishteve dhe bimëve herbale. Sipas të dhënave të siguruara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor territori i Komunës është i përbërë nga pesë kategori të tokës 39 (I – V)

Përafërsisht 550 hektarë të tokës bujqësore është në pronësi private, shumica e fermerëve kanë parcela të vogla të tokës. Lidhur me pronësinë e tokës kjo zonë është e përbërë nga toka në pronësi të personave privatë që mbulojnë një përqindje më të lartë të kësaj zone, komuna dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit. Rreth 55% e parcelave në këtë fushë janë të madhësive së vogël 0-2500,0 m². Mamusha është i përbërë nga toka bujqësore e kualitetit të mirë, e cila është shumë e përshtatshëm për prodhimin e perimeve dhe drithërave.



Degradimi I tokes- rrezik nga vërshimet

3.2.3.Përdorimi i tokës

Nga i gjithë territori i komunës së Mamushës i cili është rreth 1,094 ha, dhe pjesës më të madhe të territorit që është rreth 65.0 % (712.0 ha) është e mbuluar me tokë pjellore, rreth 19.5% (212.5 ha) është e mbuluar me pemishte, vreshta, lëndina, me pyje është e mbuluar rreth 8.50 % (93.0 ha), dhe në zonat e rregulluara, përfshirë lumenjtë, rrugët dhe përdorimet e tjera mbulojnë vetëm 7.0% (76.6 ha) të territorit të komunës .Zona pjellore për kokë banori në komunën e Mamushës është rreth 0.13 ha shifër e cila është nën limitin kritik të 0.17 ha që i nevojitet një shteti për prodhim të mjaftueshëm të ushqimit dhe reprodhim materialit për popullatën e vet.

Tabela 5.Shfrytëzimi I tokës

Përdorimi I tokës	%
Vendbanime	7.0

Tokë e punueshme	65.0
Pemtari,vreshtari,livadhe dhe kullosa	19.5
Pyje	8.5

Toka pjellore përdoret për kultivimin e kulturave të ndryshme të tilla si: domateve, trangujve, lakrave,spinaqit, pjeprit, shalqirit dhe kulturave të tjera në një sasi më të vogël. Në fakt vreshtat nuk janë prioritet i banorëve të kësaj komune dhe si rezultat është ato janë tharë, kultivohet vetëm një sipërfaqe e vogël për nevoja familjare. Ndërsa lëndinat dhe kullota përdoren për piknik dhe kullasje të bagëtisë.

Për shkak të interesit të banorëve për të mbrojtur tokën në pjesën lindore të komunës, disa familje që posedojnë tokë në veriperëndim të komunës kanë filluar ndërtimet për qëllime banimi dhe nënndarje të tokës gjë që shkakton humbjen e tokës së mirë. Përveç kësaj, gërmimet për qëllim të ndërtimit janë duke shkaktuar një efekte vizual negativ në peizazhin e përgjithshëm të komunës.

3.2.4.Ndotja e tokës

Një nga faktorët më të rëndësishëm të ndotjes së dheut është rritja e popullsisë. Rritja e popullsisë rrit kërkesat dhe si rezultat rrit sasinë e mbeturinave. Cilësia e dheut ulet për shkak të kalbjes së mbetjeve të ngurta. Kjo mund të shihet shumë shpesh në Mamushë. Rreth 77% e populates derdhin mbeturinat në hapësirat e zbrazëta dhe lumenjë, sepse nuk paguajnë tarifën kompanisë që mbledh mbeturinat. Në anën tjetër, një faktor tjetër që ndot dheun janë pesticidet dhe plehrat artificiale të përdorura në bujqësi. Përdorimi i tepërt i pesticideve dhe plehrave rrit sasinë e substancave toksike në dhe shkakton degjenerimin e strukturës së tij.

Komuna nuk ka sistem të ujitjes, qytetarët janë duke përdorur ujin nga puset, që është shumë shqetësuese sepse ky ujë nuk është testuar fare dhe si pasojë mund të ndikojë në kultura bujqësore.



Foto 20.Mbrotja e tokes nga vershimet

3.2.5.Erozioni

Në Mamushë erozioni është kryesisht me ritëm të mesëm dhe të ulët. Në mënyrë që të parandalohet erozioni në zonën e paraqitur në hartë, janë propozuar masat e mëposhtme: parandalimi i prerjes së drurit, pyllëzimi, krijimi i terracave natyrore dhe parandalimi i ndërtimeve në këtë zone.

3.2.6.Zjarret

Zjarret shkaktohen kryesisht përreth stacioneve të benzinës, nga rezervuarët e gazit dhe të naftës dhe për shkak të temperaturave të larta në pyje dhe zona bujqësore. Plani sugjeron ndërmarrjen e masave mbrojtëse për parandalimin e zjarreve në këto zona. Është e nevojshme që të krijohen dhe trajnohen grupe vullnetare në rast të katastrofave.

3.2.7.Pyjet, Kullotat dhe Livadhet

Komuna e Mamushës ka rreth rreth 8,5% të sipërfaqës më pyje ,dhe është i vendosur në një lartësi mbidetare prej 320-400m. Këto zona janë përdorur për kullotjen e kafshëve dhe në të ardhmen mund të përdoret për kullotje dhe qëllime rekreative.Lidhur me pronësinë e tokës kjo zonë është e përbërë kryesisht nga toka në pronësi të personave privatë.

Përveç kësaj, që të parandalohet prerja e druve janë sugjeruar aktivitete primare për shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj, duke përfshirë mbjelljen e fidanëve dhe ruajtjen e drunjve ekzistues.Për parandalimin e ndotjes së tokës është e rekomanduar organizimi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

3.3.Uji

Dy lumenj kalojnë përmes Komunës së Mamushës “Toplluha” dhe “Tërnja”. Lumi Toplluha, me një gjatësi prej 4 km fillon në Shkozë të Malishevës, ndërsa lumi Tërnja me një gjatësi prej 2.5 km fillon në Sallagrazhë –Suharekë. Kualiteti i ujit i këtyre lumenjve është i ulët dhe nuk përdoret për pije apo ujitje në kuadër të Komunës së Mamushës.

3.3.1.Burimet e ujit

Burimet e ujit në Komunën e Mamushës janë të shumta. Mamusha furnizohet me ujë të pijshëm nga dy rezervarët që gjenden në pjesën veri - lindore të komunës. Rezervarët furnizohen me ujë nga dy burime që gjenden në pjesën perëndimore dhe lindore të Mamushës. Rezervarët mbajnë 300.000 Litra dhe 150.000 Litra. Rrjeti i furnizimit me ujë është themeluar nga ATBNZh-ja në vitin 2005 dhe i furnizon të gjitha ndërtesat me ujë të pijshëm. Sipas zyrtarëve komunal, sasia e ujit i plotëson nevojat e qytetarëve të Mamushës. Rezervarët janë të furnizuar me pompa ujore të cilat punojnë me elektricitet. Sipas testeve kimike të bëra më 17.03.2010 kualiteti i ujit në rezervar i plotëson standardet përkatëse.

Pasi që Mamusha ka problem me furnizim të rregullt me elektricitet, reduktimet elektrike ndikojnë në furnizimin me ujë.

Një burim tjetër i ujit janë pusët në secilën shtëpi por këto puse nuk janë në ndonjë rrjet apo të lidhura me njëra tjetrën. Konsumimi nga pusët nuk kontrollohet nga autoritetet. Për më tepër janë katër fontana tradicionale (burime) që gjenden në lindje të komunës. Këto fontana publike përdoren nga fermerët në zonat përreth, për ujitje.

Rekomandimet:

- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit dhe trajtimi*
- Studimi i fizibilitetit mbi burimet e ujit të pijes*
- Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit për zhvillime të reja*
- Ndërtimi i sistemit të ujitjes*

3.3.2.Ndotja e ujërave

Është një rrjeti i kanalizimit rreth 1500 m në Mamushë, i përbërë nga dy segmente. Nuk ka asnjë trajtim operativ dhe njëri segment i rrjetit shkarkohet në ujërat sipërfaqësor – kryqëzimi i lumenjve Toplluha dhe Tërnje , i ndot të dy burimet e ujit. Kjo është një breng serioze. Segmenti tjetër është i lidhur me sistemin e kanalizimeve në Medveg (fshat në Komunën e Prizrenit). Për shkak të dimensioneve të pamjaftueshme të gypave të kanalizimit, ka nevojë për

përmirësimin e rrjetit. Megjithatë, në 2012 rrjeti i ujit dhe i kanalizimit janë nën mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e Kompanisë Rajonale të Ujit “Hidroregjioni Jugor” me bazë në Prizren.

3.3.3.Ujërat atmosferike

Si rezultat i rrugëve të kualitetit të ulët, nuk ka një sistem të duhur për kullimin e shiut përveç në rrugët periferike të cilat janë financuar nga Bashkimi Evropianë (rreth 2.5 km). E gjithë sasia e ujit të mbledhur shkarkohet në lumin Toplluha. Rruga lokale (kryesore) gjithashtu nuk ka sistem për kullimin e shiut, dhe kjo duhet të adresohet në fazat e më vonshme.

3.3.4.Hudhja e mbeturinave ne lumej

Në Komunë burimet e ndotjes së ujit janë mbeturinat e ngurta, ujërat e zeza, pesticidet dhe plehurat artificiale. Duke hedhur mbeturinat të ngurta njerëzit në mënyrë të pavetëdijshëm shkaktojnë ndotjen e ujit ashtu edhe ndotjen e tokës. Një pjesë e popullsisë që nuk paguan tarifat e kompanisë së mbeturinave i hedhin ato në zonat e zbrazura dhe në lumin Toplluha. Kjo shkakton ndotjen e lumit, zvogëlimin e kualitetit të ujit dhe përkeqësimin e natyrës. Hedhja e ujërave të ndotur në lumenj ndikon shumë në ata. Një tjetër burim i ndotjes së ujit është uji i ndotur që rrjedhin nga shtëpitë të cilat nuk kanë qasje (rreth 4,61% nuk kanë qasje dhe për rreth 35,8% të ndërtesave nuk ka të dhëna). Pesticidet e përdora në bujqësi e ndotin ujin nëntokësor.

Pasi që nuk ka një sistem të rregullt të monitorimit të kualitetit të ujit në lumenjtë Toplluha dhe Tërnje shkalla e saktë e ndotjes nuk është e njohur. Mund të vlerësohet që kanalizimet e patrajtuara shkaktojnë ndotje me lëndë ushqyese(azotit dhe fosfori) dhe ndikon në kërkesën biokimike të oksigjenit (KBO).



Foto 21.Hudhja e mbetjeve plastike në lum –Foto 22.Mbeturina ne vende publike

3.3.5.Ndotja e ujërave nëntoksore

Pasojat nga përdorimi ekstensiv bujqësor i tokës në Mamushë është e mundshme të pasqyrohet në shkallë të lart të ndotjes me nitrate (veçanërisht azotit). Gjithashtu ka të ngjarë se përveç substancave organike uji nëntokësor ndotet nga elementet kimike nga përdorimi i pesticideve. Në mënyrë që të vlerësojnë saktësisht gjendjen aktuale të problemit të ndotjes dhe të monitorojnë suksesin e masave të propozuara për të zgjidhur këtë, indikatorët kryesor të kualitetit të ujit duhet të maten rregullisht. Komuna nuk ka sistem të ujitjes, qytetarët janë duke përdorur ujin nga puset, që është shumë shqetësuese sepse ky ujë nuk është testuar fare dhe si pasojë mund të ndikojë në kultura bujqësore.

3.3.6.Vërshimet

Sipas vlerësimit të ekspertëve lumi Toplluha është lumi që vërshon, dhe i cili shkakton përmbytjen e tokës bujqësore dhe shtëpive të banimit. Gjatësia e lumit që rrezikon të dalë nga shtrati është rreth 8 km dhe përfshin zonat nga vendi i bashkimit të lumit Toplluha me lumin e Leshanit në dalje të fshatit Mamushë ku takohet me lumin e fshatit Korishë. Pjesa tjetër ku ndodhin vërshimet është përgjatë lumit të vogël. Vërshimet në Mamushë shkaktohen nga faktorët natyrorë si të rreshurat, dhe shkrirja e akullit, si dhe nga faktori njeri si mbeturinat dhe shtrati jo i rregulluar i lumit. Për ta parandaluar këtë fenomen, komuna ka filluar hartimin e projekteve për përmirësimin e shtratit të lumit duke ndërtuar muret anësore, dhe kjo konsiderohet si një nga projektet prioritare të komunës.

3.3.7.Përmbytja

Përmbytja nga lumi Toplluhë shkaktohet nga reshjet sezonale dhe nga bllokadat e shkaktuara nga mbeturinat e ngurta të hedhura nga banorët dhe mbeturinave që vijnë nga vendbanimet fqinje. Plani propozon rregullimin e shtratit dhe bregut të lumit, krijimi i korridoreve të gjelbra si dhe rekomandon parandalimin e ndërtimeve në distancë më pak se 30 m (Ligji nr. 04/L-147 mbi Ujërat) nga shtrati i lumit. Një tjetër rekomandim është edhe parandalimi i grumbullimit të mbeturinave të ngurta.

Rekomandimet

- Parandalojnë nxjerrjen e materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve,*
- Parandalimin e hedhjes së mbeturinave në lumenj,*
- Përdorimit e tepruar të pesticideve dhe plehrave kimike në bujqësi,*
- Ndërtimi i impianteve të trajtimit e ujërave të zeza,*
- Eliminimin e deponive ilegale,*

- Ndërprerjen e ndërtimeve pa leje në tokat e punueshme,
- Zvogëlim e përdorimit të druve për ngrohje përmes zgjidhjeve alternative,
- Ndërmarrjen e veprimeve që parandalojnë erozionin.

3.4.Ajri

Në Mamushë nuk ka system monitorues për matjen e kualitetit të ajrit. Ajri ndotet nga llojet e lëndëve djegëse të përdorur nga banorët zakonisht për ngrohje gjatë stinës së dimrit. Ajri ndotet ndjeshëm për shkak të përdorimit të llojeve me cilësi të dobët të lëndëve djegëse dhe teknikave të papërshtatshme të djegies. Pas djegies, ndotësit e prodhuar nga djegia përzihen me ajrin dhe dëmtojnë mjedisin dhe banorët që jetojnë aty. Në Mamushë lloji kryesor i lëndës djegëse është druri dhe në më pak raste përdoret qymyri. Veçanërisht përdorimi i qymyrit prodhon gaze të cilat të përziera me ajrin përbëjnë një kërcënim për shëndetin e popullatës.

3.4.1.Ndotja e ajrit nga pluhuri

Shkaku tjetër i ndotjes së ajrit është trafiku. Edhe pse trafiku i automjeteve në Mamushë ndikon pozitivisht në jetën sociale, efektet e tij në mjedis nuk mund të nënvlerësohen. Një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë gazet e liruar nga automjetet me naftë dhe benzinë të përdorura në Mamushë.

Një shkak tjetër i ndotjes së mjedisit është pluhuri, që shkaktohet nga rrugët e paasfaltuara. Në Mamushë ndotja shkaktohet kryesisht nga njerëzit. Shumica e ndotësve të ajrit janë ndotës sintetikë të cilët shkaktojnë ndotje mjedisore.

Edhe pse në Mamushë nuk janë present zjarret në pyje, gjatë stinës së verës mund të ndodhin, ku gazërat nga zjarret shkaktojnë ndotjen e ajrit.

3.4.2.Ndotja akustike-Zhurma

Në Mamushë faktorët që shkaktojnë zhurmën janë trafiku dhe punishtet. Po ashtu edhe automjetet e transportit të përdorura në bujqësi shkaktojnë zhurmë. Përveç kësaj, në Mamushë zhurma shkaktohet edhe nga industria dhe punishtet. Mullinjtë e grurit dhe kompanitë e prodhimit të blloqeve dhe tubave në qytet janë pranë zonave të banuara dhe zhurma e shkaktuar nga këto fabrika ka ndikim në mjedis dhe në shëndetin e banorëve.

3.5.Biodiversiteti

Mjedi natyror në Mamushë është i pasur dhe i larmishëm si në habitate ashtu edhe me kafshë të egra. Pylli është i mbjellur me drunj të ndryshëm dhe shkurre që janë vendbanim për një numër të madh të kafshëve të egra. Ekziston edhe një biodiversitet i pasur në zonën përgjatë lumenjve dhe rrugëve në fushat

bujqësore, sidomos është i pasur përgjatë lumenjve dhe rrugëve me balt për në fushat bujqësore pasi që vegetacioni është i shëndetshëm dhe ka shumë shtresa, që gjithashtu krijon një vendbanim për kafshë, insekte dhe vertebror etj

3.5.1. Flora

Pylli në pjesën lindore të komunës përbëhet nga Lisi (*Quercus sessiflora*), në formë kurore nga Dëllinja (*Juniperus ssp*), Murrizi (*Crateagus spp*) dhe llojet e ndryshme të Qershisë (*Prunus ssp*) në formë të shkurreve. Dyshemeja e pyllit ka mungesë të vegetacionit për shkak që kurorat e lisave janë të dendura.

Gjatë vizitës në teren janë gjetur llojet e ndryshme të barit dhe myshqeve. Lisat janë me shumë rrënjë pasi që prehen çdo tridhjetë vite, sipas të dhënave nga pronari. Shkopinjët përdoren për djegie. Sistemi i prerjes është system i shkëlqyer për prodhimin e drunjëve për djegie, por për shkak të biodiversitetit është më mirë drunjët të lihen të vjetërohen. Pasi që kur druri vjetërohet, rritet më shumë dhe ka më tepër lëvore dhe vrimat e kalbjes dhe bëhet një mikrohabitat i shkëlqyer për organizmat e ndryshëm. Kështu që është me rëndësi që disa drunjë të lejohen të vjetërohen.

Sa i përket gjelbërimit të lartë përbëhet kryesisht nga Plepi (*Populus ssp*), Shelgu (*Salix ssp*) dhe Akacia (*Acacia ssp*) përgjatë lumenjëve dhe llojet e ndryshme të Qershive (*Prunus ssp*), Shkoza (*Carpinus betulus*), Akacia, Plepi përgjatë shtigjeve fushore. Shkurret përgjatë shtigjeve fushore përbëhen nga Trëndafilat, Kuplra, Mjedra e Zezë (*Rubus Occidentalis*) dhe Barishtet, kurse dyshemeja nga Lepushka e Zakonshme (*Verbascum thapsus*), Geranium ssp, Myosotis ramosissima, Leontodon ssp., Hypericum perforatum, etj.

Në tokat e braktisura të ndërmarrjeve shoqërore, rrushi po rritet në mënyr të egër. Pasi që toka nuk është kultivuar për një kohë të gjatë, rritja e bimëve ka filluar. Përveç rrushit, dëllinja dhe trëndafilat janë duke u rritur. Toka përbëhet nga Boronicat e Egra (*Vaccinium vitis-idaea*), tërfili (*Trifolium*), Fleumi livadhor (*Phleum pratense*), Dredhje (*Convolvulac eae.*). Në lugina Bungu (*Quercus sessiflora*), është dominantë, por ka edhe Akacie, Dardha të Egra (*Pyrus sylvestris*), Kumbulla të Egra (*Prunus domestica*) lloje të ndryshme të panjës (*Acer ssp*), dhe Privet të Egra (*Ligustrum vulgare*), po rriten

3.5.2. Fauna

Sa i përket faunës pylli përbëhet nga zogjtë, insektet, breshkat, karkalecat, etj. Sipas pronarit të tokës në pyll gjenden edhe ujqit. Biodiversiteti është i pasur përgjatë lumenjëve dhe shtigjeve për në tokat bujqësore pasi që vegetacioni ka lulëzuar, që gjithashtu krijon një habitat të shkëlqyer për kafshë të ndryshme,

insekte, kurrizorë, etj. Në Komunë janë gjetur llojet e ndryshme të faunës si bletët, lepuri, dhelpëra, ujku, gjarpërinjët, insketet, bretkocat, zogjtë, etj

3.5.3. Problemet-Përdorimi i tepruar i plehrave

Vështrimi i përgjithshëm për biodiversitetin, flora dhe fauna është adekuate dhe speciet ekzistuese dhe vendbanimet e tyre janë të listuara. Sidoqoftë, të dhënat për speciet dhe vendbanimet e tyre nuk i përfshinë komponentin hapësinor – vend ndodhja nuk është pasqyruar në mënyrë hartografike. Në mënyrë që monitorohet vazhdimisht gjendja e biodiversitetit në të ardhmen ka nevojë që të gjenden dhe të hartohen vendbanimet aktuale. Ky lloj i regjistrimit të dhënave gjithashtu do të ndihmojë të identifikohen zonat e kërcënuara nga copëzimi dhe të ofroj masat e nevojshme në lidhje me rrethanat.

Flora dhe fauna e pasur mund të rrezikohen në disa lokacione për shkak të përdorimit të tepruar të plehrave (azotit) në tokat bujqësore dhe nga ujërat e zeza dhe mbeturinat në lumenjë. Tejkalimi i azotit mund të shihet në disa loakcione, te disa bimë si Majdanozi i Egër (*Anthiscus sylvestris*) dhe Hithi (*Urtica dioica*).

3.5.4. Masat që duhet ndërmarë

Masat për parandalimin dhe zbutjen kundër fatkeqësive natyrore ose të shtyra nga njerëzit të paraqesin një nga sfidat e Komunës. Për parandalimin dhe zbutjen e degradimit të mjedisit dhe të ndotjes sygjerohet të ndërmerren një sërë masash;

- Duke zvogëluar pesticidet dhe plehrat artificiale të përdorura për produktet bujqësore*

- Trajtimi i mbetjeve plasmasteve nga përdorimi i serrave*

- Trajtimin e ujërave të zeza,*

- Mbledhja dhe trajtimi i mbeturinave të ngurta*

- Pengimin e prerjes pa kriter të pyjeve, masës drusore.*

Pjesa 4

IV. Planifikimi I veprimeve